

029
07.5.2020



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1282 / prot.
11

Gramsh, më 06/05/2020

VENDIM
Nr. 37 Datë. 30/04/2020

**PËR DHËNIE SHPËRBLIMI NGA FONDI REZERVË PËR PËRBALLIMIN
E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN ME TERAPI INTESIVE**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës datë 30.04.2020 pasi mori në shqyrtim, kërkesën e paraqitur nga Z. Lulëzim File Miraka, i cili kërkon ndihmë financiare nga bashkia për të bijën Endrina Lulëzim Miraka datëlindja 20.03.2007 e diagnostikuar, sipas dokumenteve në dosjen e këshillit, me insuficenc renale (Probleme me veshkat) Kandidate për trasplant veshkash dhe me mjekime të vazhdueshme, diskutoj për miratimin e përdorimit të pjesshëm nga fondi rezervë të planit të buxhetit 2020, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji 9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ligjit 10296 datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ligjin 109 datë 30/10/2017 “Për buxhetin e vitit 2018” si dhe ligjin 139 datë 17/12/2015 “Për vetqeversijen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma “b” neni 54 gërma “dh”;

VENDOSI:

- 1- Dhënie e masës së shpërblimit 50.000 (pesëdhjet mijë) lekë, nga fondi rezervë për **Z. Lulëzim File Miraka**
- 2- Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri Mema



KRYETARI I KËSHILLIT

Greta Lena